

# Koordinatori Kombëtar Antitrafik

## Buletin

## Nr. 12

## Informativ

## Janar – Prill

## 2017

### *Takimi i anëtarëve të MKR-së 16 janar 2017, Tiranë*



Më 16 janar 2017, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, u mbajt takimi i radhës i anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, kryesuar nga Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme dhe njëkohësisht Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, Zj. Elona Gjebrea.

Qëllimi i takimit ishte ecuria e deritanishme e Marrëveshjes për Funkionimin e Mekanizmit Kombëtar të

Referimit (MKR) dhe angazhimi institucional i secilit anëtar të MKR, si dhe problematikat e hasura gjatë vitit 2016 në zbatimin e saj; Marrja e masave përgatitore për hartimin e Strategjisë së re; Planifikimet e aktiviteteve; Parashikimet buxhetore për to; Informacion nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbi mbështetjen financiare të qendrave për vitin 2017 si dhe fondet e alokuara për stafin e qendrave dhe parashikimi i fondit të ushqimit për vitin 2017.



### *Takim konsultativ lidhur me rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit 23 janar 2017, Tiranë*

Më 23 janar 2017, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, u zhvillua takimi konsultativ lidhur me

rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), ku anëtarët e MKR-së dhe Autoritetit Përgjegjës (AP), dhanë mendime dhe sugjerime mbi draft dokumentin e hartuar nga ekspertja e IOM Zj. Valbona Lenja.



### *Takim me KRAT Kukës 15 shkurt 2017, Kukës*

Në datën 15 shkurt, në Kukës, u zhvillua takimi i anëtarëve të Komitetit Rajonal Antitrafik të qarkut, i drejtuar nga Prefekti i qarkut dhe njëkohësisht Kryetar i Komitetit Rajonal Antitrafik, Z. Liman Morina. Në takim mori pjesë drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, drejtori i SHISH Kukës, nënprefektët e Hasit dhe Tropojës, përfaqësues nga Këshilli i Qarkut, Drejtorja Arsimore Rajonale, Drejtorja e Shëndetit Publik, bashkia Kukës, Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror,

Drejtoria Rajonale e Punësimit, përfaqësues të institucionit të Prefektit, etj.

•••

### *Takim me N/komitetin Antitrafik në Has 16 shkurt 2017, Has*

Në datën 16 shkurt u zhvillua takimi i Nënkomitetit Antitrafik të Hasit. Në takim morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës Kukës, Z. Abdulla Domi, drejtorja e Zyrës së Punësimit Has, drejtorja e qendrës spitalore, shefi i seksionit të krimit në Komisariatin e Hasit, nënprefekti i Tropojës, specialistë të bashkisë, punonjës socialë dhe psikologë të Zyrës Arsimore Has, etj.

Në fjalën e tij, Nënprefekti i Hasit, Z. Selman Geca e vuri theksin tek bashkëpunimi mes strukturave në zhvillimin e aktiviteteve ndërjegjësuese në shkolla apo në komunitet. Gjatë takimit u diskutua edhe rasti i një viktime të mundshme trafikimi, i cili u referua tek shërbimi social rajonal dhe seksioni i trafikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.

•••

### *Takim me Tryezën Teknike në Korçë 27 shkurt, Korçë*

Në datën 27 shkurt, u zhvillua takimi i anëtarëve të Tryezës Teknike të qarkut Korçë, i drejtuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Prefekturës, Zj. Mimoza Gusho.

Në takim morën pjesë nënprefektët e Kolonjës, Devollit dhe Pogradecit, përfaqësues nga Drejtoria e Policisë Vendore Korçë, Këshilli i Qarkut, Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria e Shëndetit Publik, Bashkia Korçë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Punësimit, përfaqësues të institucionit të Prefektit, përfaqësues nga OJF që operojnë në qark, etj.

Disa nga çështjet që u trajtuan në takim ishin fenomeni i lypjes, braktisja shkollore, integrimi i vajzave dhe grave të kthyer nga emigracioni, regjistrimi i fëmijëve kryesisht romë në zyrat e gjendjes civile, familje me probleme sociale, etj.

•••

### *Takim i grupit të punës “Procedura mbi bashkëpunimin mes policisë së shtetit dhe skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge” 15 mars 2017, Tiranë*

Në datën 15 mars u zhvillua takimi i grupit të punës lidhur me procedurat mbi bashkëpunimin mes policisë së shtetit dhe skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, Bashkia Tiranë, si dhe përfaqësues nga komisaritet e qarkut Tiranë.

•••

### *Takim i Autoritetit Përgjegjës 15 mars 2017, Tiranë*

Në datën 15 mars u zhvillua takimi i anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës për të diskutuar raste konkrete të referuara nga ASHMDF. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Antitrafikut, ASHMDF, Ministria e Shëndetësisë, Policia e Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror, si dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik (KKSAT). Pas diskutimit për problematikat e hasura me rastet e përmendura në takim, pjesëmarrësit lanë detyra për marrje masash lidhur me zgjidhjen e këtyre problematikave.

•••

*Takim me rrjetin e  
vullnetarëve  
23 mars 2017, Tiranë*

Në datë 23 mars 2017, u zhvillua një takim me rrjetin e nxënësve vullnetarë për ndërgjegjësimin e komunitetit rreth fenomenit të trafikimit. Takimi i paraprin fushatës sensibilizuese që MPB do të zhvillojë në disa qarqe të vendit në bashkëpunim me Komitetet Rajonale Antitrafik dhe qendrat pritëse dhe ri integruese për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

...

*Prezantimi i Urdhrit të  
Kryeministrit nr. 6, datë  
26.01.2017 “Për krijimin e  
Komitetit Rajonal të  
Luftës kundër Trafikimit  
të Personave, në çdo  
qark”  
27 mars 2017, Tiranë*



Në datë 27 mars 2017, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme u organizua takimi me qëllim prezantimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 6, datë 26.01.2017 “Për krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të

Personave, në çdo qark”. Takimi u kryesua nga Koordinatori Kombëtar Antitrafikim, Zj. Elona Gjebrea dhe Drejtori i Përgjithshëm i Antitrafikut Zj. Anila Trimi. Të ftuar në këtë takim ishin Prefektët e 12 qarqeve të vendit, Sekretarët e Përgjithshëm të këtyre qarqeve, anëtarë të KRAT-eve nga të 12 qarqet si dhe aktorë të tjerë antitrafikim.

Pas prezantimit të Urdhrit të Kryeministrit, Zj. Gjebrea diskutoi me të ftuarit mbi problematikat që janë hasur në qarqe lidhur me implementimin e Urdhrit të Ri si dhe mbi takimet periodike të KRAT-eve.

...

*Takim informues me  
nxënës të shkollës së  
mesme “Asim Vokshi” dhe  
9-vjeçare Farkë e Vogël  
28 mars 2017, Tiranë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 28 mars, Drejtorja e Antitrafikut, në bashkëpunim me organizatën D&E dhe Drejtorinë Arsimore Tiranë u zhvilluan dy aktivitete sensibilizuese me nxënës të shkollës së mesme “Asim Vokshi” dhe 9-vjeçare Farkë e

Vogël. Në këto takime u diskutua me nxënësit mbi njohuritë aktuale që ata kanë mbi trafikimin e personave, u prezantuan format e trafikimit si dhe mënyrat e parandalimit të këtij fenomeni.

...

*Takime në Komisariatin  
nr.1 dhe nr. 2, Tiranë  
3 prill 2017, Tiranë*

Në vijim të takimit të datës 15 mars, lidhur me procedurat mbi bashkëpunimin mes policisë së shtetit dhe skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge, në datë 3 prill, në Komisariatin nr. 1 dhe nr. 2, u zhvilluan takime informuese me punonjësit për të prezantuar Marrëveshjen 3 Ministrore (MPB/MAS/MMSR) dhe Planin e Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, çfarë procedurash duhet të ndjekin, Kalendarin e skuadrave të bashkisë që dalin në terren, dhe problematikat e hasura lidhur me identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge me pjesëmarrjen e rreth 60 personave, punonjës të skuadrave të terrenit të bashkisë, PMF, inspektorë zonash, shërbimi social, etj.

...

*Takim i Autoritetit  
Përgjegjës  
3 prill 2017, Tiranë*

Në datë 3 prill 2017, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, u organizua takimi i Autoritetit Përgjegjës për të diskutuar mbi disa problematika të AP-së mbi një rast konkret. Në takim u lanë disa detyra për trajtimin e rastit si dhe monitorimin e tij.

•••

*Takim informues në  
shkollën 9-vjeçare “7  
Marsi” dhe në gjimnazin  
“Ismail Qemali”  
4 prill 2017, Tiranë*



Në vijim të takimeve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 4 prill u zhvilluan 2 takime me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “7 marsi” dhe të gjimnazit “Ismail Qemali”. Në takimin e shkollës “7 marsi” morën pjesë rreth 60 nxënës dhe në gjimnazin “Ismail Qemali” 38 nxënës.

•••

*Takim në Komisarlatin nr.  
3, Tiranë*

*4 prill 2017, Tiranë*

Në datë 4 prill 2017, në Komisarlatin nr. 3, Tiranë, u zhvillua takimi i radhës informues me punonjësit e patrullave dhe inspektorët e zonave, për të prezantuar Marrëveshjen 3 Ministrore (MPB/MAS/MMSR) dhe Planin e Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, çfarë procedurash duhet të ndjekin, Kalendarin e skuadrave të bashkisë që dalin në terren, dhe problematikat e hasura lidhur me identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të ASHMDF, punonjëset e skuadrave të terrenit të bashkisë, etj, në total pjesëmarrës ishin 35 persona.

•••

*Takim informues në  
shkollën e mesme “Andon  
Z. Çajupi”  
5 prill 2017, Tiranë*



Në vijim të takimeve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 5 prill u zhvillua një takim me nxënësit e gjimnazit “Andon Z. Çajupi”.

Në takim morën pjesë rreth 30 nxënës.

•••

*Takim informues në  
shkollën 9-vjeçare “Bajram  
Curri”  
6 prill 2017, Tiranë*

Në vijim të takimeve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 6 prill u zhvilluan 2 takime me nxënësit e klasave të 8-ta dhe të 9-ta shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”. Në takim morën pjesë rreth 50 nxënës.

•••

*Takime informuese në  
shkollën e mesme “Arben  
Broci” dhe “Besnik Sykja”  
7 prill 2017, Tiranë*

Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 7 prill u zhvilluan 2 takime ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave të mesme “Arben Broci” dhe “Besnik Sykja”.

•••

*Takim informuese në  
shkollën e mesme  
“Konstandin  
Kristoforidhi”  
10 prill 2017, Tiranë*

Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në

disa qarqe të vendit, në datë 10 prill u zhvillua takimi informues në shkollën e mesme “Konstandin Kristoforidhi”, me një pjesëmarrje prej rreth 45 personash.

•••

### *Takim në Komisaratin nr. 4, Tiranë 10 prill 2017, Tiranë*

Në datë 10 prill 2017, në Komisaratin nr. 3, u zhvillua takimi informues i radhës me punonjësit e patrullave dhe inspektorët e zonave, për të prezantuar Marrëveshjen 3 Ministrore (MPB/MAS/MMSR) dhe Planin e Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, çfarë procedurash duhet të ndjekin, Kalendarin e skuadrave të bashkisë që dalin në terren, dhe problematikat e hasura lidhur me identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të ASHMDF, punonjëset e skuadrave të terrenit të bashkisë, etj, një total pjesëmarrësish prej 32 personash.

•••

### *Takim informuese në shkollën e mesme “Karl Gega” 11 prill 2017, Tiranë*

Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 11 prill u zhvillua takimi informues në shkollën e mesme “Karl Gega”, me një pjesëmarrje prej rreth 33 personash

•••

### *Takim informuese me studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër 11 prill 2017*



Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim, në kuadër të zhvillimit të takimeve ndërgjegjësuere me nxënës dhe studentë në disa qarqe të vendit, në datë 11 prill 2017 organizoi një forum ndërgjegjësuere me studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në të cilin morën pjesë rreth 60 studentë. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me Komitetin Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave Shkodër dhe Organizatës “Të ndryshëm dhe të Barabartë”.

Qëllimi i takimit ishte jo vetëm ndërgjegjësimi i studentëve dhe stafit pedagogjik mbi

fenomenin e trafikimit, dinamikën dhe pasojat e tij tek personat drejtpërdrejtë të prekur, por edhe mbi rolin e rëndësishëm që studentët luajnë në identifikimin dhe raportimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në përmirësimin e politikave shtetërore dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj viktimave të trafikimit, duke dhënë një kontribut konkret, të drejtpërdrejtë në rimëkëmbjen dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikimit.

Drejtoresha e Përgjithshme e Antitrafikut dhe Azilit dhe përfaqësuesja e organizatës “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” informuan studentët mbi format e trafikimit, mënyrat dhe treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, asistencë dhe ndihma që iu jepet këtyre viktimave, format e raportimit, sikurse **Linja Kombëtare 116006** dhe **Aplikacioni “Raporto! Shpëto!”**.

Gjatë takimit u prezantua fotonovela “Një ëndërr e shkelur” dhe “Një fillim i ri”, si dhe u shpërndanë materiale ndërgjegjësuere.

•••

### *Takim informuese në shkollën e mesme Teknike Ekonomike Tiranë 12 prill 2017, Tiranë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 12 prill u zhvillua takimi informues në shkollën e mesme “Teknike Ekonomike Tiranë”, me një pjesëmarrje prej rreth 23 personash.



*Takim informuese në shkollën e mesme jopublike “Aristoteli” dhe Qendra Rezidenciale Zyber Hallulli  
18 prill 2017, Tiranë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 18 prill u zhvillua takimi informues në shkollën e mesme jopublike “Aristoteli” dhe Qendra Rezidenciale Zyber Hallulli.



*Takim informuese në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” ku morën pjesë rreth 60 student dhe pedagogë*

*19 prill 2017, Vlorë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 19 prill u zhvillua takimi informues në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” ku morën pjesë rreth 60 studentë dhe pedagogë.



*Takim informuese në shkollën e mesme “Lef Sallata” dhe “Mustafa Qemal Ataturk”  
20 prill 2017, Vlorë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 18 prill u zhvillua takimi informues në shkollën e mesme “Lef Sallata” dhe “Mustafa Qemal Ataturk” ku morën pjesë 165 nxënës.



*Takim informuese në shkollën 9 vjeçare “Azem Hajdari” dhe shkollën e mesme Oso Kuka  
27 prill 2017, Shkodër*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 26 prill u zhvilluan 2 takime informues në shkollën 9 vjeçare “Azem Hajdari” dhe në shkollën e mesme “Oso Kuka” në Shkodër.



*Takim informues në shkollën 9 vjeçare Met Hasa Durrës dhe shkollën e mesme “Ibrahim Rrugova” Kamëz  
27 prill 2017, Tiranë*



Në zbatim të kalendarit të aktiviteteve informuese në disa qarqe të vendit, në datë 27 prill u zhvilluan 2 takime informues në shkollën 9 vjeçare Met Hasa Durrës dhe shkollën e mesme “Ibrahim Rrugova” Kamëz.



*Takim me Policinë e Shtetit në Drejtorinë e Policisë  
28 prill 2017, Tiranë*

Në datën 28 prill 2017, përfaqësues nga Drejtoria e Antitrafikut realizuan një takim konsultativ lidhur me problematikat e hasura lidhur me Linjën Falas 116 006 në ndihmë të viktimave të trafikimit si dhe mundësitë për përmirësimin e këtyre problematikave.





REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

---

## Zyra e Koordinatorit Kombëtar

Adresa : Sheshi: "Skënderbej", nr. 3,

Tiranë

Shqipëri

Tel & Faks: 00355 4 223 3540/539

e-mail: [koordinator.kombetar@punetebrendshme.gov.al](mailto:koordinator.kombetar@punetebrendshme.gov.al)

<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/antitrafiku>